

# Vlerësimi i punës së nxënësit

Informim për prindërit

Brochure destinée aux parents de langue albanaise

« Çdo fëmijë ka të drejtë për një mësim që i ofron kënaqësi, aftësim, si dhe integrimin e tij shoqëror. »

Kushtetuta e kantonit Vo (Vaud), neni 36

Gjinia mashkullore, e përdorur më lart, për terminologjinë që i përket roleve dhe funksioneve, ka një kuptim gjithëpërfshirës, e jo përjashtues. Kjo u përshtatet si femrave, ashtu edhe meshkujve.

© 2005 DFJ – Drejtoria e përgjithshme e mësimit të detyrueshëm

## Përmbajtja

1. Përse është i nevojshëm vlerësimi i nxënësve ?	5
2. Çka vlerësohet te nxënësit ?	6
3. Si bëhet vlerësimi i nxënësve ?	6
4. Si komunikohen rezultatet e punimeve të rëndësishme?	8
5. Si merren vendimet lidhur me ndjekjen e shkollimit të nxënësit ?	9
6. Situata të veçanta	11
7. Dokumente	11
8. Cilat janë të drejtat e prindërve ?	12
9. Çfarë pret shkolla nga prindërit ?	13
10. Kalimi nga një shkollë private në një shkollë publike	13

## Shtojcat

Ku të informohemi ?	14
Glosar	15
Shema e shkollës së Kantonit Vaud	16

## Hyrje

Të dashur prindër,  
Më 1 gusht 2005, rregulla e re për vlerësimin e punës së nxënësit ka hyrë në fuqi, bashkë me këtë janë bërë edhe ca modifikime në ligjin shkollor lidhur me *Rregullat e zbatimit* të saj dhe me *Planin e përgjithshëm të vlerësimit*.

Broshura me titull: *vlerësimi i punës së nxënësit* ju jep informatat e duhura për ta njohur më mirë atë që shkolla kërkon dhe pret nga nxënësi, si dhe për t'ju mundësuar ta përcillni më mirë shkollimin e fëmijës suaj.

Ndryshimet e bëra në fillim të vitit të ri shkollor 2005, kanë të bëjnë me krijimin e raporteve më të afërta ndërmjet prindërve dhe shkollës, kryesisht përmes një mbledhjeje vjetore, përmes takimeve individuale të organizuara me kërkesën e prindërve ose mësuesve gjithashtu përmes një komunikimi më të qartë të rezultateve të punës së nxënësit gjatë tërë vitit shkollor.

Rregulla e re parasheh, gjithashtu, përf forcimin në frëngjisht e kryesisht në lexim, duke kërkuar një trajtim të njëjtë për gjithë nxënësit, si në cilësi të vlerësimit, ashtu edhe në provimet kantonale të standardizuara. Kjo rregull ka për qëllim një baraspeshë në kërkesat kantonale.

Procedura e orientimit vazhdon të mbështetet në shumë kritere. Prindërit u bashkohen analizës së këtyre kritereve.

Departamenti i formacionit dhe i rinisë do t'i japë përparësi një vlerësimi që është i nevojshëm për mësimet shkollore dhe që e respekton ligjshmërinë. Gjithashtu dëshiron që zbatimi i dispozitave të reja ta përmirësojë cilësinë e shkollimit të detyrueshëm si dhe bashkëpunimin e nevojshëm në mes jush dhe mësimeve.

Anne-Catherine Lyon

Këshilltare e Shtetit  
Shefe e Ministrisë  
I formimit dhe i rinisë

## 1. Pse vlerësohet nxënësi?

- **Për ta ndihmuar nxënësin të përparojë në formimin e tij**

Në këtë drejtim, mësimi dallon varësisht nga nevojat e nxënësve. Vlerësimi i tij është i vënë në shërbim të mësimave shkollorë. Ai ia mundëson nxënësit të përparojë e mësuesit ta përshtatë më mirë mësimin. Me një fjalë, ky quhet **vlerësim formues**.

- **Për t'i vlerësuar njohuritë dhe për t'i bërë ato të mjaftueshme për vazhdimin e shkollimit të nxënësit**

Vlerësimi i nxënësit shërben, gjithashtu, për ta bërë bilancin e njohurive dhe aftësive të arritura gjatë vitit shkollor. Kjo formë e vlerësimit, e quajtur **vlerësim përfundimtar**, duhet të bëjë të mundur marrjen e vendimeve për nxitjen, orientimin ose certifikimin.

- **Për të siguruar një përdorim të drejtë të vlerësimit të nxënësve dhe një sistem shkollor cilësor**

Vlerësimi duhet të kontribuoj gjithashtu në cilësinë e sistemit shkollor. Provimet kantonale zyrtare (ECR) sjellin informata të dobishme për harmonizimin e kërkesave në nivelin e kantonit dhe në vlerësimin e sistemit shkollor të kantonit VO (Vaud).

## 2. Çfarë vlerësohet te nxënësit ?

- **Arritja e qëllimeve**

Puna e nxënësit vlerësohet në lidhje me qëllimet e *Planit dhe programit mësimor të kantonit Vo (PEV)*<sup>1</sup>.

- **Qëndrimi ndaj mësimave shkollorë**

Qëndrimi ndaj mësimave shkollorë përbën bazën e një mësimi të rregullt. Vëzhgimet përqendrohen gjithashtu mbi metodën e punës individuale ose në grup.

- **Sjellja e nxënësit**

Vlerësimi i sjelljes mbështetet në respektimin e rregullave të shkollës, e që këto rregulla u komunikohen si nxënësit, ashtu edhe prindërve.

Në rast se nuk i rrespekton rregullat, nxënësi mund të ndëshkohet me : detyra shtesë, mësim plotësues mbas mbarimit të mësimi, përjashtim të përkohshëm ose të përhershëm.

## 3. Si bëhet vlerësimi i nxënësve ?

- **Me punë të rregullt ose të ngjashme**

Rezultatet e punëve shkollorë janë të vlerësuara nga punimet e rregullta të shpërndara gjatë gjithë vitit shkollor. Këto punime vlerësojnë aftësitë e nxënësit për të përdorur njohuritë ose teknikat në një situatë të caktuar.

Punët e rregullta përbëjnë pjesën qenësore të vlerësimit përfundimtar.

---

<sup>1</sup> Fjalët e shkruara me italic figurojnë në glosar, faqe 15

Një varg punësh të thjeshta të përqendruara kryesisht mbi njohuritë dhe teknikat, mund të përbëjnë bazën e një vlerësimi ose të një note. Kjo përmbledhje punësh të thjeshta mban emrin **punime të përmbledhura**.

Punimet e parapara për vlerësimin e nxënësve janë të paralajmëruara me herët. Mësimdhënësi, gjithashtu, i njofton me qëllimet dhe kriteret të cilat përdoren për vlerësim..

#### ➤ **Me provime zyrtare kantonale (ECR)**

ECR janë të hartuara nga departamenti për tërësinë e kantonit. Ato janë të standardizuara dhe mbahen për të gjithë nxënësit e një niveli të caktuar, në të njëjtën datë, në të njëjtat kushte.

Rezultatet e nxënësit në këto provime luajnë një rol tregues në procedurat e kalimit të vitit, të orientimit dhe të certifikimit.

Ato u tregohen prindërve sipas dimensioneve që u mundësojnë atyre t'i kuptojnë rezultatet e fëmijëve të tyre në raport me mesataren kantonale.

#### ➤ **Me vlerësimin e qëndrimit të nxënësit ndajpunës shkollore dhe sjelljes së tij në klasë**

Vlerësimi i qëndrimit të nxënësit ndaj punës shkollore përbën thelbin e njoftimeve për nxënësin. Mund t'i jepen vërejtje atij dhe prindërve, drejtpërdrejt në punime ose në ditar.

Për sjelljen në klasë, nxënësit vazhdimisht i tërhiqet vërejtja me gojë, dhe/ose me shkrim në ditar.

## 4. Si jepen rezultatet e punës së rregullt ?

#### ➤ **Në shkollën fillore me vlerësime**

Në ciklin fillor, mësimdhënësit përdorin një shkallë prej 5 vlerësimesh, për t'i dhënë rezultatet e punës së nxënësve. Ato janë :

- objektivat e arritura shumë mirë ;
- objektivat e arritura mirë ;
- objektivat e arritura ;
- objektivat e arritura përafërsisht ;
- objektivat e paarritura ;

Në fund të ciklit, falë këtyre vlerësimeve dhe me anën e një bilanci, merret vendimi për kalimin në ciklin më të lartë ose jo.

#### ➤ **Në ciklin e lartë të shkollës fillore**

Në ciklin e ndërrimit, për të vlerësuar punët e nxënësve, mësimdhënësit përdorin një shkallë vlerësimi që fillon nga 1 deri në 6 me gjysmë pikë.

- -nota 4 përbën minimumin e objektivave të arritura
- nota 6 simbolizon objektivat e arritura shumë mirë
- nota 1 tregon që asnjë objektivi nuk është arritur, as përafërsisht.

Në fund të vitit shkolror, nga këto nota nxirret mesatarja për çdo disiplinë, të llogaritura me gjysmëpikë dhe nuk ekziston më një mesatare e mesatareve.

## 5. Si merren vendimet lidhur me shkollimin e nxënësit ?

### ➤ Suksesi në fund të ciklit

Si rregull, nxënësi e përfundon secilin cikël fillor për dy vjet. Nëse ka sukses dhe i arrin objektivat kryesore të lëndëve, ai e kalon vitin. Në raste tjera, arsimtari bashkë me prindërit e analizojnë situatën. Kalimi prej një viti në vitin tjetër, brenda të njëjtit cikël, bëhet automatikisht.

Në përfundim të ciklit fillor (CYP1), nxënësi duhet t'i ketë arritur objektivat e ciklit të parë në lexim, në mënyre që të kalojë në ciklin e dytë fillor (CYP2).

Vendimi që nxënësi ta kalojë apo jo vitin, merret nga *këshilli i mësimdhënësve*.

### ➤ Orientimi në fund të ciklit të ndërrimit

Orientimi bazohet në kritere të ndryshme : shkalla e përvetësimit të objektivave të parapara në program, përparimet e arritura gjatë ciklit shkollor, aftësia për t'iu përshtatur rrethanave të reja të mësimin dhe qëndrimi ndaj mësimin shkollor në përgjithësi.

Gjatë muajit janar të klasës së 6-të ose *këshilli i klasës ua* komunikon **prindërve një** vlerësim të parë sa i përket orientimit. Një takim me prindërit dhe mësimdhënësit mundëson marrjen e një vendimi (pas një analizimi të situatës së nxënësit) të vlefshëm për orientimin e tij.

Pastaj, gjatë muajit maj *këshilli i klasës u* dërgon prindërve një **propozim të arsyetuar** për orientimin e nxënësit. Pas këtij propozimi mund të organizohet një takim tjetër, ndërmjet prindërve dhe mësimdhënësve.

Në rast mospajtimi me vendimin e marrë, dhe pasi që prindërit shkruajnë një ankesë, konferenca e mësuesve merr vendimin për orientimin e nxënësit, në njërin prej tri degëve të niveleve 7-të deri 9-të (VSO, VSG, VSB)

### ➤ Në fund të niveleve 7-të deri 9-të

Nxënësi e kalon vitin ose e merr certifikatën e mbarimit të shkollimit, nëse nuk ka marrë më shumë se 3 pikë negative mbi tërësinë e lëndëve ose disiplinave, për të cilat maksimumi i pikëve negative në frëngjisht dhe matematikë është 2 ( pikë negative).

Në mbarim të nivelit të 7-të, nxënësi ka mundësi të orientohet përsëri prej VSO në VSG ose prej VSG në VSB nëse i plotëson këto kushte :

- nëse e kalon vitin ose klasën me sukses
- nëse i merr se paku 15 pikë në tërësinë e vlerësimeve në frëngjisht, në matematikë dhe në gjuhë të huaj
- nëse prindërit e bëjnë kërkesën

### ➤ Certifikata në fund të nivelit të 9-të

Certifikata e shkollimit të mesëm jepet në bazë të mesatares që nxënësi merr në secilën disiplinë dhe rezultatet e tij në provime. Nota e provimit llogaritet sa çereku i notave për notën e vitit shkollor.

Nxënësve që nuk e marrin certifikatën, u jepet një vërtetim për përfundimin e shkollës.

## 6. Situata të veçanta

Në disa situata të veçanta (shpërngulje, mosnjohje e frëngjishtes, sëmundje, handicap...) zbatimi i rregullave të vlerësimit mund të lërë përshtypjen të jetë shumë rigoroz kur konstatohet një përparim potencial, se paku në disa disiplina.

Në këtë rast, vendimet për të lëshuar certifikatën mund të mbështaten në faktorë të tjerë, e jo vetëm në rezultatet e punës së nxënësit.

Këta faktorë mund të merren në konsiderim vetëm kur është në dobi të nxënësit e kurrsesi në dëm të tij.

## 7. Dokumentet

### ➤ Ditari

Ditari është dokument që shërben si dëshmi dhe mjet komunikimi midis shkollës dhe prindërve. Vlerësimet ose notat e punimeve të rregullta figurojnë në fund, në listën e rezultateve.

### ➤ Libreza shkollore

Në librezën shkollore shënohen rezultatet që nxënësi i merr në fund të ciklit dhe vendimet e marra për shkollimin e mëtutjeshëm.

### ➤ Dosja e vlerësimit

Dosja e vlerësimit ka për qëllim ta favorizojë dialogun ndërmjet prindërve dhe shkollës. Ky dokument përbëhet prej librezës shkollore, prej provimeve kantonale referuese dhe prej punimeve që e vënë në pah përparimin e nxënësit. Në dosjen e vlerësimit figurojnë, gjithashtu, edhe dokumentet e shërbimit të edukatës fizike dhe sportive.

## 8. Cilat janë të drejtat e prindërve?

Në fillim të çdo viti shkollor organizohet një mbledhje informative për prindërit. Në këtë rast flitet për objektivat e *Planit të studimeve të kantonit Vo (PEV)*, për mënyrat e vlerësimit, për rregullat në klasë dhe për çdo faktor që kontribuon për mbarëvajtjen e shkollës.

Përveç kësaj, agjenda dhe punimet e nxënësit japin një mundësi të privilegjuar për t'i informuar prindërit rregullisht rreth mësimëve në vijim dhe për rezultatet që i merr nxënësi.

Marrëdhëniet e shëndosha dhe bashkëpunimi në mes shkollës dhe familjes, e favorizojnë përparimin e nxënësit në shkollë. Si prindërit, ashtu edhe mësimmësuesit, në rast nevojë, mund të kërkojnë të takohen.

Në të shumtën e rasteve këto lloje takimesh janë të nevojshme kur konstatohen vështirësi dhe ngecje lidhur me mësimet, ose nëse ka probleme rreth sjelljeve të nxënësit në shkollë.

### ➤ E drejta për t'u ankuar në rast mospajtimi me vendimet

Prindërit mund të bëjnë ankesë te Ministria në lidhje me vendimet e marra për shkollimin e fëmijës së tyre ose për sanksionet eventuale të ndërmarra kundër tij (përfshirë nga shkolla). Drejtoria e shkollës iu informon për mënyrën dhe afatin për të bërë ankesë në çastin kur iu njofton drejtoria për vendimin e saj. Prindërit kanë të drejtë ta japin mendimin e tyre. Ata kanë mundësinë ta konsultojnë dosjen.

## 9. Çfarë pret shkolla nga prindërit ?

Artikulli 3 i ligjit shkollor e njeh **rolin kryesor të prindërve në fushën e edukimit**. Ndërsa atë të mësimi ia beson shkollës.

Për mbarëvajtjen e shkollimit të nxënësit, një dialog me prindërit është më se i nevojshëm. Ligji civil zviceran, në nenin e tij 302, i detyron prindërit të « ***bashkëpunojnë në mënyrë adekuate me shkollën*** ».

Prindërit detyrohen të njoftohen mbi informatat që u janë transmetuar përmes ditarit të nxënësit. Ata e nënshkruajnë çdo javë duke e vërtetuar në të njëjtën kohë, me nënshkrimin e tyre që janë njoftuar me rezultatet e fëmijës së tyre kur ato u janë prezantuar.

## 11. Kalimi nga një shkollë private në një shkollë publike

Prindërit, fëmija i të cilëve është shkolluar në një shkollë private ose në shtëpi, mund ta regjistrojnë në një shkollë publike. Në muajin e prillit-fillimi i vitit shkollor, ata i drejtohen me shkrim drejtoris së shkollës së vendbanimit të tyre. Regjistrimi në një cikël a shkollë vendoset nga drejtori, duke pasur parasysh bazuar në moshën, dosjen shkollore dhe njohuritë e nxënësit.

Në muajin maj, një provim kantonal organizohet çdo vit për të vendosur në cilin drejtim duhet të orientohet nxënësi që ka arritur moshën e duhur për të kaluar në klasën e 7, 8 apo 9.

Madje, dispozitat e parapara për nxënësit që vijnë nga një shkollë private janë po të njëjtat me ato për nxënësit e një shkolle publike. Për shembull, një nxënës që ka kaluar vitin ose ka marr certifikatën, nuk mund ta përsërisë vitin.

## Shtojca

### Ku të këshillohemi ?

Për t'u këshilluar lidhur me fëmijun, prindërit drejtohen, para se gjithash, te mësimmshënësi e pastaj në drejtorinë e shkollës në të cilën ai ndodhet, si dhe në drejtorinë e përgjithshme të shkollimit të detyrueshëm (D.G.E.O.) për raste të veçanta.

Këshillat praktike për prindërit ( tekste, vepra mbi edukimin dhe mësimin) që janë të publikuara, gjithashtu, në faqen e internetit të DFJ/ D.G.E.O.

**Ligji shkollor dhe Rregullorja për zbatimin e tij janë në dispozicion në adresën :**

[www.rsv.vd.ch](http://www.rsv.vd.ch)

Për ta konsultuar PEV (plani i studimeve voduaze), **le Cadre général de l'évaluation**, broshura : **La formation dans le canton de Vaud**:

[www.dfj.vd.ch](http://www.dfj.vd.ch)

## Glosari

**Këshilli i klasës** : mbledhja e mësimeve të klasës që japin mësim në të njëjtën klasë.

**Konferenca e mësimeve të klasës** : mbledhja e mësimeve të klasës që japin mësim në të njëjtën shkollë.

**Plani i studimeve voduaze (PEV)**: lista e objektivave për t'u arritur nga nxënësit e secilit cikël a shkallë të shkollës së detyrueshme.

**Objektivat kryesorë** : zgjedhja e objektivave të cilat të gjithë nxënësit duhet t'i arrijnë për ta kaluar ciklin ose për të kaluar në klasë më të lartë.

**Pikët negative** : mbledhja e të gjitha pikëve dhe gjysmë pikëve që mungojnë për të arritur nivelin e mjaftueshëm ( nota 4).

Për shembull : nota 3=1 pikë negative; nota 2=1,5 pikë negative

**VSO**: Drejtimi i ciklit të lartë të fillores me zgjedhje të zanateve

**VSG**: Drejtimi i përgjithshëm i ciklit të lartë të fillores


**VSB**: Drejtimi i ciklit të lartë të fillores drejt gjimnazit



# Shkollimi në kantonin VO (VAUD)

Mëso, o specializuar për nxënësit me të meta

Pedagogjia plotësuese për nxënësit me vështirësi në mësim



1 MSSP : maturë e specializuar, shënimi socio-pedagogjik

2 MPC : maturë profesionale komerciale

3 **OPTI** : zakonisht, është e hapur për nxënësit që kanë mbaruar shkollimin e detyruar por që nuk janë të përcaktuar rreth shkollimit të mëtejshëm.

**Drejtoria e përgjithsme e mësimit të detyruar (DGEO)**

Rue de la Barre 8 • 1004 Lausanne, Tél. 021 316 32 32, Fax 021 316 31 44  
 info.dgeo@vd.ch, www.dfj.vd.ch